

Lënda: Mbi ankesën e z. Selajdin Sulejmani

## MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

TIRANË

### **Për dijeni: Z. Selajdin Sulejmani**

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të regjistruar me nr. 1667 prot, datë 01.03.2023, ju sqarojmë si më poshtë:

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, me vendimin për caktim pensioni nr.5033, datë 28.12.2021, i ka caktuar z. Selajdin Muharem Sulejmani pension pleqërie nga data 15.12.2021, me 24 vite e 1 muaj periudhë sigurimi, me masë fillestare të pensionit 11,345 lekë në muaj.

Në vjetërsinë e punës nuk është llogaritur periudha 03.01.1994 - 31.12.1995, në ish-Ndërmarrjen e Bonifikimit Korçë.

Sipas dokumentacionit që administrohet në dosje rezulton se, për periudhën 01.01.1994 - 31.12.1995, emri i z. Selajdin Sulejmani nuk figuron në listë - pagesa.

Z. Sulejmani është i datëlindjes 16.07.1955 dhe plotësonte moshën për pension pleqërie, bazuar në nenin 92, të ligjit 7703/1993, të ndryshuar, në datën 16.07.2020.

Z.Sulejmani ka aplikuar për pension pleqërie në datën 15.12.2021.

Bazuar në nenin 62 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është përcaktuar se: “Personi, i cili kërkon pensionin jo më vonë se 1 vit nga data që i lind kjo e drejtë, ky pension i paguhet që nga kjo ditë. Në raste të tjera pensioni do të paguhet nga data e paraqitjes së kërkesës për pension”.

Z. Selajdin Muharem Sulejmani është informuar nga DRSSH Korçë me shkresën nr. 7327 prot., datë 02.04.2022.

Faleminderit për mirëkuptimin.